



OPŠTINA NOVO BRDO

Në bazë të nenit 16, paragrafi 3 të Rregullores MF-Br-04/2017 për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, komisioni për vlerësimin e propozimeve të paraqitura në Thirrjen Publike për mbështetje financiare publike të projekteve/programeve të organizatave joqeveritare nga fusha e mbrojtjes së qytetarëve në situata emergjente, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.03.2026, ka marrë këtë:

VENDIM

mbi listën paraprake të përfituesve

Nr.ren	Emri i NVO	Emërtimi i projektit	Fusha	Numri mesatar i pikëve	Shuma e miratuar e projektit në €
1.	Shoqata e Zjarrfiksive Vullnetar Gjilan (SHZV)	Organizimi i pjesëmarrjes vullnetare të qytetarëve në shpëtimin e njerëzve dhe pasurisë në situata emergjente.	Mbrojtja e qytetarëve në situata emergjente.	75	159,999.96 €

1. Rezultatet paraprake bëhen përfundimtare pas përfundimit të të gjitha procedurave të parapara me Rregulloren MF-Br-04/2017 për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
2. Vendimi të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komunës së Novobërdës.

ARSYETIM

Komuna e Novobërdës, më datë 24.02.2026, në bazë të vendimit nr. 02/169, ka shpallur Thirrjen Publike për mbështetje financiare publike të projekteve/programeve të OJQ-ve në fushën e mbrojtjes së qytetarëve në situata emergjente, në shumën totale prej 160,000.00 €. Thirrja publike ka qenë e hapur për 15 ditë pune nga dita e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Komunës së Novobërdës. Me thirrjen publike janë përcaktuar kriteret për dorëzimin e projekteve dhe formularët që duhet të dorëzohen detyrimisht gjatë aplikimit.

Me vendimin e kryetarit të komunës nr. 02/209, të datës 06.03.2026, është formuar Komisioni për vlerësimin e aplikacioneve të paraqitura në Thirrjen Publike. Në mbledhjen e Komisionit për vlerësimin e propozimeve të paraqitura në Thirrjen Publike (Procesverbali nr. 02/288), të mbajtur më datë 26.03.2026, është bërë hapja e ofertave dhe me këtë rast është konstatuar se në afatin e paraparë është dorëzuar gjithsej një (1) aplikacion, konkretisht nga OJQ "Shoqata e Zjarrfikësve Vullnetar Gjilan (SHZV)".

Gjatë verifikimit është konstatuar se aplikacioni i plotëson kushtet formale të thirrjes publike, pas së cilës komisioni vendosi që në të njëjtën mbledhje të kryejë edhe vlerësimin e aplikacionit në përputhje me nenin 18 të Rregullores MF-Br-04/2017 për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve. Aplikacioni nga ana e Komisionit ka marrë mesatarisht 75 pikë.

Duke pasur parasysh se projekti i OJQ "Shoqata e Zjarrfikësve Vullnetar Gjilan (SHZV)" i ka përmbushur kushtet dhe kriteret e parapara me Rregulloren MF-Br-04/2017 për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, është vendosur që aplikacioni të pranohet dhe të miratohen mjete financiare në shumën prej 159,999.96 € për projektin e propozuar.

Në përputhje me nenin 16, paragrafi 3 të Rregullores MF-Br-04/2017 për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, është vendosur si në dispozitivin e vendimit.

Udhëzim juridik: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë të paraqesë ankesë pranë Komisionit për shqyrtimin e ankesave në Komunën e Novobërdës, në afat prej 5 ditësh nga dita e publikimit të vendimit.

Komisioni për vlerësim


Valdete Bunjaku, kryetare e komisionit


Andjela Dimic, anëtar


Flamur Uka, anëtar


Srdjan Todorovic, anëtar


Slobodan Markovic, anëtar